REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA KUSHTETUESE

УСТАВНИ СУД

CONSTITUTIONAL COURT

Raporti vjetor
Godišnji izveštaj
Annual Report
2016

Raporti vjetor / Godišnji izveštaj / Annual Report / 2016

Prishtinë, 2017

REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

RAPORTI VJETOR
GODIŠNJI IZVEŠTAJ
ANNUAL REPORT
2016

Prishtinë, 2017

RAPORTI VJETOR 2016

Përmbajtja

Përmbajtja. 8

VIZIONI DHE MISIONI 10

FJALA HYRËSE E KRYETARES SË GJYKATËS KUSHTETUESE 12

FJALA E SEKRETARIT TË PËRGJITHSHËM 14

RAPORT VJETOR I GJYKATËS KUSHTETUESE PËR VITIN 2016 15

SEKRETARIATI I GJYKATËS KUSHTETUESE 18

I. DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS DHE BURIMEVE NJERËZORE (DABNJ) 22

II. DEPARTAMENTI I PËRKRAHJES PROFESIONALE (DPP) 30

III. DEPARTAMENTI I REGJISTRIMIT TË LËNDËVE, STATISTIKËS DHE ARKIVIT (DRLSA) 34

IV. DEPARTAMENTI I BUXHETIT DHE FINANCAVE (DBF) 42

V. NJËSIA E PROKURIMIT (NJP) 48

VI. NJËSIA E TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT DHE MULTIMEDIAVE (NJTIKM) 52

VII. AUDITIMI (NJA) 56

VIII. NJËSIA LIGJORE (NJL) 60

IX. ZYRA PER KOMUNIKIM DHE INFORMIM (ZKI) 64

X. AKTIVITETET E GJYKATËS KUSHTETUESE 68

SHTOJCA I. 76

ORGANOGRAMI 78

VIZIONI DHE MISIONI

1. Vizioni

Republika e Kosovës është shtet demokratik, i bazuar në sundimin e ligjit dhe në respektimin e të drejtave të njeriut dhe të dinjitetit njerëzor, të garantuara me Kushtetutë. Në Kosovë, ku qytetarët vendosin nëpërmjet përfaqësuesve të tyre, të cilët janë përgjegjës para tyre, Gjykata Kushtetuese do të jetë një institucion të cilin qytetarët e Kosovës e shohin si autoritet përfundimtar dhe garantues të Kushtetutës dhe të respektimit të ligjit.

E drejtuar nga Kushtetuta, Gjykata do t'i kontribuojë: (1) ndërtimit të një shteti të lirë, demokratik dhe paqedashës; (2) garantimit të të drejtave të secilit qytetar, lirive qytetare dhe barazisë së të gjithë qytetarëve dhe komuniteteve para ligjit; dhe (3) eliminimit të gjurmëve të së kaluarës, duke krijuar tradita të reja juridike, të bazuara në sundimin e ligjit, në demokraci dhe në të drejta të njeriut.

2. Misioni

Si institucion i ri në demokraci të re, Gjykata Kushtetuese ka një rol të rëndësishëm në përmbushjen e vizionit të lartpërmendur. Megjithatë, Gjykata do të ballafaqohet me sfida të konsiderueshme ndaj përmbushjes së këtij roli, sepse ndryshimet e brendshme nuk janë të mjaftueshme. Gjykata, po ashtu, duhet të inkurajojë ndryshimet e jashtme. Këto dy aspekte janë të ndërlidhura ngushtë njëra me tjetrën. Vizioni nuk mund të arrihet pa një zhvillim të arsyeshëm të brendshëm të Gjykatës dhe ndikimit të ndërsjellë ndërmjet Gjykatës Kushtetuese dhe forcave të jashtme shoqërore, ekonomike, kulturore dhe teknologjike.

Si rrjedhojë e kësaj, në pajtim me vizionin e lartpërmendur, Gjykata Kushtetuese e Kosovës i ka parashtruar vetes mision që të jetë:

Institucion profesional, kompetent dhe i pavarur, që është duke krijuar një traditë të re të paanshmërisë dhe të pavarësisë gjyqësore, si dhe të llogaridhënies së plotë në shërbim të qytetarëve të Kosovës;

Institucion transparent, që mbron me sukses të drejtat dhe liritë themelore të qytetarëve dhe të komuniteteve të Kosovës, duke gjykuar në mënyrë të drejtë dhe transparente, brenda juridiksionit të saj, dhe duke mbikëqyrur drejtësinë në ushtrimin dhe në përdorimin e kompetencave të përcaktuara nga Kushtetuta; dhe

Autoritet përfundimtar i rendit kushtetues të vendit, duke siguruar dhe duke mbështetur transicionin e Kosovës drejt të drejtave të njeriut, demokracisë dhe sundimit të ligjit.

FJALA HYRËSE E KRYETARES SË GJYKATËS KUSHTETUESE, ARTA RAMA HAJRIZI

Kam kënaqësinë dhe nderin të paraqes Raportin vjetor 2016. Raporti vjetor ofron një pasqyrë të aktiviteteve të Gjykatës gjatë vitit 2016, me fokus të veçantë në punën dhe në rezultatet e departamenteve dhe të njësive të administratës së Gjykatës Kushtetuese. Raporti përmban, ndër të tjera, të dhëna të përmbledhura statistikore përkitazi me numrin e lëndëve të trajtuara, seancat e mbajtura, kërkesat e parashtruara, shkeljet e supozuara, shpenzimet buxhetore, aktivitetet e prokurimit, auditimin e brendshëm dhe numrin e përgjithshëm të të punësuarve në Gjykatë. Raporti gjithashtu përmban të dhëna për konferencat dhe punëtoritë e organizuara, vizitat e realizuara në vend dhe jashtë vendit dhe pjesëmarrjen në trajnime të stafit profesional të Gjykatës.

Të dhënat e paraqitura në raportin vjetor, përveç se janë dëshmi e punës së kryer me përkushtim dhe profesionalizëm nga gjyqtarët dhe nga stafi i Gjykatës, njëherësh janë edhe motiv shtesë për angazhim të mëtutjeshëm në tejkalimin e sfidave në të ardhmen.

Edhe gjatë vitit 2016, Gjykata vendosi për një sërë rastesh të rëndësishme, si autoritet përfundimtar për interpretimin e Kushtetutës si dhe duke marrë parasysh jurisprudencën relevante të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Nga rastet më të rëndësishme që u shqyrtuan, dëshiroj të veçoj kërkesën KO118/16, të parashtruar nga 12 deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 113(5) të Kushtetutës, me të cilin u kërkua vlerësimi i kushtetutshmërisë së Ligjit nr. 05/L-120 për Trepçën, përkatësisht nëse ai Ligj shkel nenet 46 [Mbrojtja e Pronës], 58 [Përgjegjësitë e Shtetit], 60 [Këshilli Konsultativ për Komunitete], 78 [Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve] dhe 81 (1) [Legjislacioni me Interes Vital] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Kërkesë tjetër e rëndësishme ishte gjithashtu edhe kërkesa KO73/16, e parashtruar nga Avokati i Popullit, në pajtim me nenet 113(2) dhe 135(4) të Kushtetutës, me të cilën u kërkua vlerësimi i kushtetutshmërisë së Qarkores Administrative nr. 01/2016, të nxjerrë nga Ministria e Administratës Publike e Republikës së Kosovës, më 21 janar 2016. U kërkua që Gjykata Kushtetuese të vlerësojë nëse Qarkorja Administrative nr. 01/2016 cenon pavarësinë e institucioneve të pavarura kushtetuese të përfshirë në Kapitullin XII të Kushtetutës, specifikisht pavarësinë e Avokatit të Popullit të garantuar me nenin 133 të Kushtetutës.

Gjithashtu, vlen të ceket edhe kërkesa KI18/16, e parashtruar në Gjykatë nga Bedri Salihu, në pajtim me nenin 113(7), me të cilën u kërkua vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme te Kosovës, Rev. nr. 308/2015, të 12 nëntorit 2015. Gjykata konstatoi se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme kishte shkelur të drejtat e parashtruesit të kërkesës të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 [E drejta për një proces të rregullt] të Konventës Evropiane për të Drejta të Njeriut.

Përveç kësaj, me qëllim të shkëmbimit të ideve dhe të përvojave në drejtësinë kushtetuese dhe të forcimit të marrëdhënieve profesionale e miqësore, unë dhe gjyqtarët e Gjykatës zhvilluam edhe vizita zyrtare në gjykata kushtetuese të vendeve të tjera, në institucione të tjera shtetërore prestigjioze dhe në konferenca ndërkombëtare. Vizita të tilla u realizuan në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, në Turqi, në Bullgari, në Slloveni, në Shqipëri dhe në Mal të Zi.

Më 27 dhe 28 tetor 2016, Gjykata Kushtetuese shënoi Vitin e Shtatë Gjyqësor të Gjykatës, duke organizuar Konferencën ndërkombëtare për: "*Kontrollin incidental si mekanizëm kushtetues*

në sigurimin e kushtetutshmërisë së ligjeve në vendet në tranzicion". Përveç përfaqësuesve të institucioneve të Republikës së Kosovës, në Konferencë morën pjesë edhe delegacione nga gjykatat kushtetuese të vendeve të tjera, si: Portugalia, Turqia, Bullgaria, Shqipëria dhe Maqedonia.

Në fund, shpreh falënderimin dhe mirënjohjen e thellë për të gjithë partnerët dhe donatorët ndërkombëtarë të Gjykatës, e në veçanti për: Agjencinë Gjermane për Zhvillim Ndërkombëtar (GIZ), Agjencinë e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID), Fondacionin Gjerman për Bashkëpunim Ligjor Ndërkombëtar (IRZ) dhe Zyrën e Këshillit të Evropës në Kosovë. Të gjitha këto, sikurse edhe në vitet e kaluara, ofruan mbështetje të çmuar dhe të vazhdueshme për ngritjen e kapaciteteve të Gjykatës nëpërmjet organizimit të punëtorive, të seminareve dhe të aktiviteteve të tjera trajnuese.

Gjykata Kushtetuese dhe gjyqtarët e saj do të vazhdojnë të kryejnë me përgjegjësi dhe me devotshmëri punën e tyre për mbrojtjen e kushtetutshmërisë në vend, në përputhje me misionin e dhënë dhe gjithmonë duke i qëndruar besnikë Kushtetutës së Kosovës.

Arta Rama-Hajrizi

Kryetare e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës

FJALA E SEKRETARIT TË PËRGJITHSHËM, MILOT VOKSHI

Kam kënaqësinë e veçantë të paraqes Raportin vjetor 2016 të punës së Sekretariatit të Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejmë: Sekretariati) për vitin 2016. Sekretariati mbështet Gjykatën Kushtetuese dhe siguron funksionimin efikas të administratës.

Ky raport vjetor ofron një pasqyrë të aktiviteteve të Gjykatës gjatë vitit 2016, me fokus të veçantë në punën dhe në rezultatet e secilit departament dhe të secilës njësi të administratës së Gjykatës Kushtetuese.

Sekretariati në 2016, ishte i angazhuar me përkushtim të madh në arritjen e objektivave të punës dhe në përmbylljen me sukses të projekteve të parapara në Planin e punës 2016, si dhe në Planin Strategjik të Gjykatës 2014-2017.

Në mënyrë të veçantë, ai ishte i fokusuar në plotësimin e pozitave të punës, në aftësimin dhe në ngritjen e mëtejme të kapaciteteve profesionale të personelit dhe në zhvillimin, në hartimin e në zbatimin e mëtejmë të rregullave dhe të procedurave të punës, për të siguruar një performansë sa më të lartë të Sekretariatit, brenda përgjegjësive që ka.

Sekretariati ka tejkaluar me sukses ballafaqimin me sfidat dhe ka arritur plotësisht objektivat e punës, duke zhvilluar aktivitetet e planifikuara dhe duke realizuar synimet e parapara në afate kohore,.

Përmbushja e objektivave të identifikuara është fryt i punës ekipore të personelit të Sekretariatit. Prandaj, përfitoj nga rasti t'i shpreh mirënjohje gjithë personelit të Sekretariatit për kontributin e dhënë dhe për rezultatet e arritura në zbatimin e planeve të punës, si dhe në sigurimin e funksionimit me efektivitet të lartë të Gjykatës.

Një falënderim të veçantë e meritojnë donatorët, të cilët, me asistencën e tyre gjatë vitit 2016, ndikuan në arritjen e sukseseve të përgjithshme të Gjykatës.

Në emrin tim dhe në emër të stafit të Sekretariatit, dëshiroj t'i falënderoj gjyqtarët dhe kryetaren e Gjykatës, mr. sc. Arta Rama Hajrizi për inkurajimin, për përkrahjen dhe për mbështetjen pa rezervë, si dhe për udhëzimet e qarta dhe profesionale që na kanë ofruar në tejkalimin e sfidave, përderisa përkushtimi i pashembullt dhe profesionalizimi i tyre, i treguar në interpretimin e Kushtetutës, vazhdon ta mbajë Gjykatën Kushtetuese ndër institucionet më të fuqishme, më të respektuara dhe me besueshmërinë më të lartë në vend.

Sekretariati, po ashtu, edhe në vitin 2017, do të mbetet i përkushtuar në zbatimin e Planit të punës dhe të Planit Strategjik për periudhën 2014-2017.

Milot Vokshi

Sekretar i Përgjithshëm

RAPORT VJETOR I GJYKATËS KUSHTETUESE PËR VITIN 2016

Hyrje

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës është autoriteti përfundimtar në Republikën e Kosovës për interpretimin e Kushtetutës dhe për përputhshmërinë e ligjeve me Kushtetutën dhe është plotësisht e pavarur në kryerjen e përgjegjësive të saj.

Në vitin 2016, Gjykata Kushtetuese pranoi 151 kërkesa të reja.
Ajo vendosi për 172 kërkesa të dorëzuara në Gjykatë në vitin 2016; ajo i publikoi 143 vendime në ueb-faqen e Gjykatës dhe ua dorëzoi palëve.
Të gjitha vendimet e Gjykatës Kushtetuese u publikuan në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Në pajtim me nenin 115.2 të Kushtetutës dhe në pajtim me rregullin 14 (3) i) të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, Gjykata Kushtetuese aprovoi raportin e saj vjetor për vitin 2016, në seancën administrative të mbajtur më 6 korrik 2017.

Sekretariati, në pajtim me nenin 115.2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe në pajtim me rregullin 14 të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, organizoi mbarëvajtjen e 4 (katër) seancave administrative, ku u morën 15 (pesëmbëdhjetë) vendime. Ndër vendimet më të rëndësishme ishin:

- Aprovimi i Raportit vjetor për vitin 2015;
- Vendimi përndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit mbi praktikat nr. 06/2012 mbi funksionimin dhe strukturën e Njësisë Ligjore; dhe
- Aprovimi i Planit vjetor të punës së Sekretarit të Përgjithshëm për vitin 2016.

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës ishte e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare,
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar,
Robert Carolan, gjyqtar, (deri më 9 shtator 2016),
Altay Suroy, gjyqtar,
AlmiroRodrigues, gjyqtar,
Snezhana Botusharova, gjyqtare,
Bekim Sejdiu, gjyqtar,
Selvete Gerxhaliu-Krasniqi, gjyqtare, dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare.



Arta Rama-Hajrizi,
kryetare

Ivan Čukalović,
zëvendëskryetar

Robert Carolan
gjyqtar (deri më 9 shtator 2016)



Altay Suroy,
gjyqtar

AlmiroRodrigues,
gjyqtar

Snezhana
Botusharova,
gjyqtare



Bekim Sejdiu,
gjyqtar

Selvete Gerxhaliu-
Krasniqi,
gjyqtare



Gresa Caka Nimani,
gjyqtare

SEKRETARIATI I GJYKATËS KUSHTETUESE

Sekretariati, në pajtim me nenin 12 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese dhe në pajtim me rregullin 15 të Rregullores së punës, ka kryer punët administrative dhe ka mbështetur punën e Gjykatës Kushtetuese.

Sekretariati udhëhiqet nga Sekretari i Përgjithshëm, i cili sipas nenit 12.4, është përgjegjës për organizimin dhe drejtimin e Sekretarisë. Struktura organizative e tij përbëhet nga:

- Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm;
- Departamenti i Administratës dhe i Burimeve Njerëzore (DABNJ);
- Departamenti për Regjistrim të Lëndëve, Statistikë dhe Arkiv (DRLSA);
- Departamenti i Përkrahjes Profesionale (DPP);
- Departamenti për Buxhet dhe Financa (DBF);
- Njësia e Prokurimit (NJP);
- Njësia e Teknologjisë së Informacionit, e Komunikimit dhe e Multimedieve (NJTIKM);
- Njësia e Auditimit të Brendshëm (NJAB); dhe
- Zyra për Komunikim dhe Informim (ZKI).

Plani Strategjik i Gjykatës Kushtetuese për periudhën 2014-2017, ka paraparë të gjitha aktivitetet për zhvillim gjatë vitit 2016; Sekretairati ka realizuar 90% të aktiviteteve të planifikuara.

Njësia Ligjore (NJL), përfshin pozitat e këshilltarëve juridikë dhe personelin tjetër ligjor. Struktura dhe organizimi i saj, janë rregulluar me Udhëzimin për praktikat, i miratuar nga Gjykata. Këshilltarët juridikë mbështesin punën profesionale të gjyqtarëve.

Sekretariati i ka realizuar këto objektiva të vitit:

- Implementimi i Planit Strategjik 2014-2017; dhe
- Rregullore nr. 01/2016 mbi ndryshimin dhe plotësimin e rregullores nr. 03/2015 për avancimin dhe për transferimin e stafit të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës;

Sekretariati gjithashtu publikoi:

- Raportin vjetor për vitin 2015; dhe
- Buletinin e vendimeve 2015, volumi I dhe II, në tri gjuhë.

Sekretariati, prezantoi në seanca administrative:

- Raportin e tremujorit të katërt, tetor-dhjetor 2015;
- Raportin e tremujorit të parë, janar-mars 2016;
- Raportin e tremujorit të dytë, prill-qershor 2016;
- Raportin e tremujorit të tretë, korrik-shtator 2016.

DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS DHE BURIMEVE NJERËZORE (DABNJ)

I. DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS DHE BURIMEVE NJERËZORE (DABNJ)

I. Burimet njerëzore dhe ngritja e kapaciteteve

- Bazuar në planin e rekrutimit, janë përgatitur dhe shpallur 3 (tri) konkurse publike dhe 1 (një) konkurs i brendshëm për avancim. Me konkurs publik është bërë përzgjedhja e një Këshilltari Juridik (senior), dhe dy këshilltarëve juridikë (junior). Ndërkohë, Këshilltari Juridik senior dhe një Këshilltar Juridik junior, ka filluar punën gjatë vitit 2016, përderisa këshilltari tjetër juridik junior pritet të filloj punën pas aprovimit të rekomandimit të komisionit përzgjedhës në seancë administrative.

- Më 9 shtator 2016, gjyqtari ndërkombëtar Robert Carolan ka paraqitur dorëheqjen e tij, përkatësisht kërkesën për moszgjatje të mandatit nga skadimi i vendimit të 14 qershorit 2016. Ndërsa, më 14 shtator 2016, në përputhje me nenin 8.2 të Ligjit nr. 03/L-121, Kryetarja e Gjykatës, ka kërkuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës të fillohet me procedurën e emërimit të gjyqtarit të ri në Gjykatën Kushtetuese.

- Në periudhën raportuese, dy këshilltarë juridikë junior janë avancuar në pozitën Këshilltar Juridik senior, ndërsa ka pasur një avancim, në rrafshin horizontal, ngritje të pagës për pozitën e këshilltarëve juridikë junior, sekretarit juridik në Njësinë Ligjore dhe të përkthyesve në GJKK.

- Gjatë viti 2016, dy këshilltarë juridikë senior kanë dhënë dorëheqje ndërsa një Këshilltari Juridik senior i është mundësuar pushimi pa pagesë, për një periudhë 4 (katër) mujore. Përderisa një Këshilltari Juridik junior nuk i është konfirmuar vazhdimi i kontratës së punës për shkak të dështimit në periudhën provuese.

- Gjatë vitit 2016, janë kontraktuar gjithsej 3 (tre) punonjës për shërbime të veçanta, një përkthyes, një asistent administrativ dhe një zyrtare për financa.

- Në periudhën raportuese, kanë kryer praktikën 7 kandidatë, të përzgjedhur sipas konkursit publik në GJKK.

- Janë ofruar udhëzimet në lidhje me ndihmën në drejtimin dhe mbikëqyrjen e burimeve njerëzore menaxherëve të linjës në të gjitha çështjet që lidhen me menaxhimin e stafit nën drejtimin e tyre.

- Numri i përgjithshëm i të punësuarve në listën e pagave është 65 veta, prej të cilëve, 36 janë të gjinisë mashkullore, apo 54%, ndërsa 29 të gjinisë femërore, gjegjësisht 46%, kurse sa i përket përkatësisë nacionale 56 janë shqiptarë (83%), 5 serbë (10%), 2 turq (3%), 1 boshnjak (2%) dhe 1 malazias (2%). Në këtë numër të listës së pagave janë përfshi edhe ish kryetari i GJKK-së si dhe tre zyrtarët e emëruar nga ai sipas ligjit në fuqi.

- Kanë përfunduar vlerësimet e kryerjes së punëve për vitin aktual 2016, për stafin e administrativ të Gjykatës.

Figura nr. 1:Numri i të punësuarve sipas përkatësisë nacionale:



Figura nr.2: Numri i të punësuarve sipas gjinisë1



II. Ngritja e kapaciteteve

Me qëllim të ngritjes së mëtejme të kapaciteteve dhe aftësive vepruese, si dhe sa i përket zbatimit të politikave të aftësimit të stafit në kuadër të Gjykatës Kushtetuese, përgjatë vitit 2016 janë organizuar këto aktivitete: punëtori jashtë vendit (6), punëtori brenda vendit (1), vizita studimore/zyrtare jashtë vendit (8), konferencë jashtë vendit (3), me konferencë brenda vendit (1), seminar brenda vendit (2), forum jashtë vendit(1), forum brenda vendit 1, shkollë verore jashtë vendit (1), trajnime brenda vendit (15), trajnime jashtë vendit (2), kurs i gjuhëve të huaja (1). Më konkretisht:

- Tri punëtori lidhur me zbatimin e Planit Strategjik 2014-2016, janë mbajtur në Durrës, me gjithsej 53 pjesëmarrës nga Gjykata;

- Një Punëtori Orientuese për gjyqtarët e rinj të Gjykatës Kushtetuese është mbajtur në Budvë, të Malit të Zi, me 24 pjesëtarë nga Gjykata, duke përfshirë edhe Kryetaren e Gjykatës, Arta Rama-Hajrizi;

- Një punëtori me temën: "Mbi antikorrupsionin" është mbajtur në Selanik, me 10 pjesëmarrës nga ana e Gjykatës, duke përfshirë edhe 6 (gjashtë) gjyqtarë. Ndërsa, një Punëtori e përbashkët ndërmjet Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës dhe asaj të Shqipërisë, është mbajtur në Durrës me 10 pjesëmarrës nga ana e Gjykatës;

- Punëtoria "Mediet dhe institucionet: Transparenca kundrejt konfidencialitetit" është mbajtur në Prishtinë, me një pjesëmarrës nga Gjykata;

- Tre pjesëtarë nga Gjykata Kushtetuese zhvilluan dy vizita studimore, 5 mujore në Gjykatën e Strasburgut, me qëllim të përvetësimit sa më të mirë të praktikave të gjyqësisë evropiane dhe zbatimin e tyre në gjyqësinë kushtetuese të Kosovës;

- Dy vizita zyrtare janë bërë në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë në Tiranë, me 21 pjesëmarrës, duke përfshirë edhe Kryetaren e Gjykatës, Arta Rama-Hajrizi;

- Në "Simpoziumin e organizuar me rastin e 54 vjetorit të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Turqisë", kanë marrë pjesë 4 pjesëtarë nga ana e Gjykatës, duke përfshirë edhe kryetaren e gjykatës, Arta Rama Hajrizi. Një gjyqtar i Gjykatës ka marrë pjesë në inaugurimin e Vitit Gjyqësor të Gjykatës Supreme të Republikës së Turqisë "Day of Honour" në Ankara.

- Një vizitë zyrtare është zhvilluar me rastin e përvjetorit të 25-të themelimit të Gjykatës Kushtetuese të Sllovenisë, me tre pjesëmarrës nga Gjykata, duke përfshirë edhe kryetaren e Gjykatës, Arta Rama-Hajrizi. Një takim tjetër i organizuar nga Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë është mbajtur në Sarandë, me 4 pjesëtarë të Gjykatës sonë;

- Një konferencë për "Gratë gjyqtare dhe sundimi i ligjit" është mbajtur në Washington me dy pjesëmarrës nga Gjykata, duke përfshirë edhe kryetaren e Gjykatës, Arta Rama-Hajrizi. Konferenca tjetër "Gjenerata e re mbi auditimin e brendshëm: zgjidhja e problemeve 2016", është mbajtur në Budapest me dy pjesëmarrës nga Gjykata. Përveç kësaj, konferenca rajonale "Mbi drejtësinë Administrative në Ballkanin Perëndimor", është mbajtur në Podgoricë, me dy pjesëmarrës nga Gjykata;

- Një konferencë e organizuar nga Këshilli i Evropës, është mbajtur në Prishtinë, me 22 pjesëmarrës;

- Një seminar për "Marrëdhëniet e Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës Supreme me medie", organizuar nga Këshilli i Evropës, është mbajtur në Prishtinë, me 10 pjesëmarrës nga Gjykata; Seminari informues mbi anëtarësimin dhe kooperimin me Komisionin Evropian për demokraci përmes ligjit, është mbajtur në Prishtinë, ku kanë marrë pjesë 16 pjesëtarë nga Gjykata, duke përfshirë edhe 4 gjyqtarë;

- Një Forum rajonal është mbajtur në Sarajevë, me një pjesëmarrës nga Gjykata; Forumi gjyqësor mbi "sigurimin e zbatimit uniform të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut nga gjykatat kushtetuese dhe gjyqësorit të zakonshëm" është mbajtur në Prishtinë, me 16 pjesëmarrës nga Gjykata, duke përfshirë edhe kryetaren e gjykatës, Arta Rama-Hajrizi;

- Shkolla verore (Summer School), organizuar nga Gjykata Kushtetuese e Turqisë është mbajtur në Turqi,, me 2 pjesëmarrës nga Gjykata;

- Një trajnim lidhur me prokurimin elektronik, është mbajtur në Tiranë, me 2 pjesëmarrës nga Gjykata; një trajnim tjetër për "Prokurim Publik", është mbajtur në Durrës, me 5 pjesëmarrës nga Gjykata;

- Trajnimet brenda vendit, 5 nga fusha e financave, me 5 pjesëmarrës; 2 nga fusha e jurisprudencës, me 24 pjesëmarrës, 1 për protokoll, me 1 pjesëmarrës; 1 trajnim nga fusha e prokurimit me 8 module, organizuar nga KRPP dhe IKAP, me 2 pjesëmarrës; 2 trajnime nga fusha e Teknologjisë Informative, me 3 pjesëmarrës nga Gjykata; dhe 1 trajnim me dy module nga pakoja ECDL me 18 pjesëmarrës; 1 trajnim nga fusha e administratës, është mbajtur në IKAP, me 1 pjesëmarrës; 1 nga fusha e lidershipit dhe politikave publike, organizuar nga USAID dhe AUK, me 4 pjesëmarrës; dhe 1 për "Mbajtja e Tatimit në burim në Paga dhe Kontribute Pensionale", me 8 pjesëmarrës nga Gjykata;

- Kursi i gjuhës frënge, është financuar nga Ambasada e Francës në Kosovë; orët janë mbajtur në Gjykatë me 1 pjesëmarrës.

Figura nr. 3: Pjesëmarrja në trajnime, punëtori, seminare dhe vizita studimore



III. Mbështetja administrative dhe logjistike

- Janë drejtuar, mbikëqyrë dhe menaxhuar me sukses punët administrative brenda afateve kohore dhe në mënyrë efikase në përputhje me mandatin e DABNJ-së. Në këtë kontekst, janë siguruar të gjitha shërbimet e kërkuara në sferën e logjistikës, transportit dhe distribuimit të materialit shpenzues dhe pajisjeve të IT-së, është bërë mbikëqyrja dhe monitorimi i tyre;

- 282 fatura ishin regjistruar në Sistemin *Free Balance*, pas furnizimit me material shpenzues dhe me pajisje të IT-së, si dhe shërbimeve për nevoja pune të GJKK-së;

- Njëkohësisht, është mbikëqyrur mirëmbajtja dhe servisimi i rregullt i veturave të Gjykatës si dhe përpilimi me kohë i raporteve mujore lidhur me shpenzimin e derivateve.

- Janë përpiluar dhe adresuar shkresat përkatëse drejtuar institucioneve të ndryshme lidhur me ekzekutimin e kërkesave të ndryshme administrative, pagave dhe mëditjeve.

- Është menaxhuar procesi i zbatimi të planit Strategjik të GJKK-së si dhe janë ndërmarrë aktivitetet shtesë dhe monitoruar procesi i zbatimit të Planit të Veprimit për vitin 2016. Në këtë kontekst, është hartuar plani i veprimit për vitin 2017, në zbatim të Planit Strategjik 2014-2017, si dhe është bërë menaxhimi i rrezikut përmes përpilimit të regjistrit të rrezikut në arritje të objektivave strategjike të GJKK-së.

- Për sa më sipër, në baza javore, mujore dhe 3 (tre) mujore ishin përpiluar raportet e veçanta të punës dhe janë dorëzuar me kohë në Zyrën e Sekretarit të Përgjithshëm.

IV. Shërbimet e bibliotekës

Gjatë vitit 2016, në bibliotekën e Gjykatës, janë pranuar dhe regjistruar këto: libra; buletine; revista; vendime; raporte dhe gazeta zyrtare:

- 4 libra juridikë nga Akademia Turke e Drejtësisë; 2 libra nga Këshilli Kushtetues i Francës; 2 libra nga Komuniteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq; 1 libër nga Këshilli i Evropës; 2 libra nga Gjykata Kushtetuese e Bosnjës dhe Hercegovinës; 1 libër në gjuhën gjermane nga lëmi politik; 10 libra në gjuhën angleze, të lëmit juridik nga donatorë individual dhe 4 libra në gjuhën shqipe, të lëmit juridik, nga donatorë individual; 1 libër në gjuhën shqipe, lidhur me Konventën për të Drejtat e Njeriut; 1 libër me përmbledhje të Jurisprudencës së Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit në gjuhën shqipe, serbe dhe atë angleze; 2 libra juridikë nga Gjykata Kushtetuese e Sllovenisë, njeri nga ta me vendime të përzgjedhura 1991-2015;

- 3 buletine nga Komisioni i Venecias për vitin 2015/1; 2 për vitin 2015/2; 2 për vitin 2015/3; 1 buletin i Praktikës Gjyqësore të GJKK-së, si dhe 1 buletin i Praktikës Gjyqësore të Gjykatës Supreme të Kosovës 2016, në 3 gjuhë;

- 1 Revistë e Vjenës mbi të Drejtën Kushtetuese Ndërkombëtare, nga "ICL Journal" dhe 1 revistë " FlyInn", shkurt 2016;

- 16 vendime të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, për të drejtën e pronës: 1993-2014/2015, 8 vendime të përzgjedhura 1996-2014, dhe 1 me vendime të vitit 2015, nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kroacisë;

- Raporti vjetor 2015 i Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit, në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze, me nga 1 kopje; Raporti vjetor 2015 i Agjencisë Kosovare të Pronës, me një kopje në gjuhën shqipe dhe një në atë serbe; si dhe Raporti Vjetor i Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut në Kosovë;

- Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës; nr. 1, 2, 3, 4 të muajit janar 2016, nr. 5,6,7 të muajit shkurt 2016 dhe nr. 8, 9, 10 të marsit 2016, nr. 11,12, 13, 14 e prillit 2016; nr. 15, të majit 2016; me nr. 16, 17, 18, 19, 20 e qershorit 2016, nr. 21, 22 qershor 2016; nr. 23, 24, 25, 26, 27, korrik 2016; me nr. 28, 29, 30, 31 të gushtit 2016; nr. 32, 33, 34 shtator 2016, nr. 35, 36 e tetorit, dhe 37, 38, 39 e nëntorit, secila me nga 3 kopje nga Zyra për Publikimin e Gazetës Zyrtare.

Përfundimet:

Edhe përkundrejt përkufizimeve dhe sfidave të hasura, është arritur që të ofrohen në kohë shërbimet e domosdoshme për funksionimin e Gjykatës, në çështjet që varen nga mandati i DABNJ-ës.

DEPARTAMENTI I PËRKRAHJES PROFESIONALE (DPP)

II. DEPARTAMENTI I PËRKRAHJES PROFESIONALE (DPP)

Departamenti i Përkrahjes Profesionale (DPP) është përgjegjës për ofrimin e shërbimeve profesionale të përkthimit, të redaktimit, të lekturës dhe të harmonizimit të terminologjisë në të gjitha dokumentet e Gjykatës Kushtetuese në gjuhët në të cilat punon GJKK-ja.

DPP-ja ka organizuar, ka udhëhequr dhe ka mbikëqyrur punën e përkthimit (në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze e për ueb-faqen zyrtare të Gjykatës edhe në gjuhën turke), të redaktimit e të lekturës (në gjuhën shqipe dhe në gjuhën serbe) dhe të përkthimit aty për aty (simultan). Kështu, nëpër DPP kanë kaluar 18.818 faqe, ose mesatarisht 69 faqe në ditë, të shkresave, të dokumenteve të ndryshme, të aktgjykimeve, të aktvendimeve, të vendimeve për heqje nga lista, të raporteve paraprake e të tjera në gjuhën shqipe, në gjuhën serbe, në gjuhën angleze dhe në gjuhën turke.

Përkthyesit kanë bërë 697 orë e 42 minuta përkthime simultane në takime të rregullta, në seanca të Gjykatës, në seanca administrative, në intervista të kandidatëve për pozitat e shpallura nga GJKK-ja, si dhe në takime të tjera.

Në bashkërenditje me DRLSA-në, DPP-ja ka përgatitur dokumentacionin e nevojshëm për takimet e gjyqtarëve dhe për seancat shqyrtuese e administrative.

DPP-ja ka bërë procedimin e lëndëve në gjuhën shqipe, në gjuhën serbe dhe në gjuhën angleze. Njëkohësisht, ka kontribuar në publikimin e vendimeve në shqip, në serbisht, në anglisht dhe në turqisht.

Objektivat

Objektivat që ka arritur DPP-ja janë këto:

- Standardizimi i të gjitha dokumenteve zyrtare dhe i të gjitha vendimeve që mbajnë vulën e Gjykatës Kushtetuese;
- Eliminimi i mospërputhjeve në aktgjykime, në aktvendime, në raporte paraprake e në dokumente të tjera të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës;
- Nxitja në përmirësimin e kapaciteteve njerëzore dhe organizative për të vënë në praktikë menaxhimin dhe planifikimin me pjesëmarrje të drejtpërdrejtë dhe për të ngritur bashkëpunimin ndërmjet departamenteve;
- Bashkëpunimi me operatorin ekonomik, sa i përket përkthimit (jashtë Gjykatës dhe në Gjykatë); dhe
- Jetësimi me sukses i të gjitha objektivave që dolën në vitin 2016 nga Plani strategjik i GJKK-së, 2014-2017.

DEPARTAMENTI I REGJISTRIMIT TË LËNDËVE, STATISTIKËS DHE ARKIVIT (DRLSA)

III. DEPARTAMENTI I REGJISTRIMIT TË LËNDËVE, STATISTIKËS DHE ARKIVIT (DRLSA)

1. Statusi i lëndëve

Gjatë vitit 2016, Gjykata ka pasur në punë gjithsej 252 kërkesa/lëndë:

- 101 kërkesa janë bartur nga vitet 2014/2015, prej të cilave 93 janë zgjidhur dhe 8 janë në proces;
- 151 kërkesa janë pranuar në vitin 2016, prej të cilave 79 janë zgjidhur dhe në proces janë 72 apo në total 80 kërkesa;
- gjithsej 80 kërkesa janë në proces.

Gjithsej 172 kërkesa janë zgjidhur ose 67,8% e të gjitha rasteve në dispozicion (252).

Gjatë vitit 2016, 143 vendime janë publikuar në ueb-faqen e Gjykatës dhe janë proceduar te palët, ndërsa 27 kërkesa të zgjidhura janë në proces të përgatitjes.

DINAMIKA E KËRKESAVE SIPAS MUAJVE
(1.1.2016- 31.12.2016)



Në vitin 2016, Gjykata Kushtetuese ka nxjerrë 5 aktgjykime:

- Aktgjykim në rastinKO73/16, i parashtruar nga Avokati i Popullit,vlerësimi i kushtetutshmërisë së Qarkores Administrative nr. 01/2016, të nxjerrë nga Ministria e Administratës Publike të Republikës së Kosovës, më 21 janar 2016.

- Aktgjykim në rastinKI65/15, Parashtrues: TatjanaDavila, Ljubiša Marić, Zorica Krsenković, Zlata Jevtić. vlerësim i kushtetutshmërisë së mospërmbarimit të 3 (tri) aktgjykimeve të Kolegjit të Apelit të Agjencisë Kosovare të Pronës të Gjykatës Supreme,

përkatësisht aktgjykimeve nr. GSK-KPA-A-021/12, të 17 janarit 2013, GSK-KPA-A-141/12, të 17 prillit 2013 dhe GSK-KPA-A-045/12, të 3 tetorit 2012, dhe 2 (dy) vendimeve të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës, përkatësisht KPCC/D/A/211/2013, të 21 gushtit 2013 dhe KPCC/D/C/216/2013, të 22 nëntorit 2013.

- Aktgjykim në rastin KI18/16, i parashtruar nga Bedri Salihu, vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 308/2015, të 12 nëntorit 2015.

- Aktgjykim në rastin KI132/15, i parashtruar nga Manastiri i Deçanit. vlerësim i kushtetutshmërisë së dy vendimeve të 12 qershorit 2015, nr. AC-I-13-0008 dhe nr. AC-I-13-0009, të Kolegjit të Ankesave të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

- Aktgjykim në rastin KI135/14, parashtrues IKK Classic, vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, E. Rev. nr. 21/2014, të 8 prillit 2014.

2. Parashtrimi i kërkesave

Juridiksioni dhe palët e autorizuara për parashtrimin e kërkesës në Gjykatën Kushtetuese është i përcaktuar me Kushtetutën e Kosovës dhe Ligjin për Gjykatën Kushtetuese të Kosovës. Besimi i qytetarëve në Gjykatën Kushtetuese është rritur dukshëm si rezultat i punës efikase, efektive dhe të paanshme, 151 kërkesa janë pranuar gjatë vitit 2016, që do të thotë se janë pranuar mesatarisht 12,6 kërkesa në muaj dhe janë zgjidhur 14,2.

Struktura e kërkesave të parashtruara është:

- 134 kërkesa individuale (nga personat fizikë), ose 88,7%; dhe
- 17 kërkesa, ose 11,3% nga personat juridikë.

3. Shpërndarja e kërkesave

DRLSA i ka proceduar në pajtim me nenin 22 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të gjitha kërkesat e parashtruara sipas nenit 113 të Kushtetutës.

Shpërndarja e kërkesave/lëndëve për gjyqtarët raportues është bërë në përputhje me rregullin 8 dhe 34 të Rregullores së punës së Gjykatës. Përjashtim nga ky rregull është shpërndarja e kërkesave për vënien e masës së përkohshme, të cilat kërkesa procedohen sipas rregullit 55 të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese, dhe rasteve *adhoc,* të cilat paraqesin konflikt interesi, në përputhje me nenin 18 të Ligjit për gjykatat dhe rregullin 7 të Rregullores së punës.

4. Qasja në Gjykatë dhe besimi i publikut në punën e Gjykatës

Të gjithë qytetarët e Kosovës, pavarësisht nga përkatësia etnike a fetare, kanë qasje të barabartë në Gjykatën Kushtetuese.

- 107 kërkesa,ose 70,9% janë parashtruar nga shqiptarët;
- 18 kërkesa,ose 11,9%, janë parashtruar nga serbët;
- 3 kërkesa, ose 2,0%, janë parashtruar nga turqit;
- 1 kërkesë,ose 0,7%, është parashtruar nga RAE;

- 1 kërkesë, ose 0,7%, është parashtruar nga malazezët;
- 4 kërkesa, ose 2,6%, janë parashtruar nga nacionalitetet të tjera;
- 17 kërkesa, ose 11.3%, janë parashtruar nga autoritetetë tjera publike (persona juridikë).

STRUKTURA ETNIKE E PARAQITËSVE TË KËRKESAVE



5. Shkeljet e supozuara

Tipologjia e shkeljeve të supozuara nga 151 kërkesat e pranuara në vitin 2015 është si në vijim:

- Neni 21 [Parimet e përgjithshme), 12 raste ose 7,9%;
- Neni 22 [Zbatimi i drejtpërdrejtë i marrëveshjeve dhe instrumenteve ndërkombëtare], 3 raste ose 2 %;
- Neni 24 [Barazia para ligjit], 16 raste ose 10,6 %;
- Neni 31 [E drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm], 56 raste ose 37,1%;
- Neni 32 [E drejta për mjete juridike], 1 rast, ose 0,7%;
- Neni 45 [Të drejtat zgjedhore dhe të pjesëmarrjes], 1 rast, ose 0,7%;
- Neni 46 [Mbrojtja e pronës], 36 raste, ose 23,8%;
- Neni 49 [E drejta e punës dhe ushtrimit të profesionit], 6 raste ose 4,0%;
- Neni 51 [Mbrojtja shëndetësore dhe sociale], 1 rast, ose 0,7% ;
- Neni 54 [Mbrojtja gjyqësore e të drejtave], 3 raste, ose 2,0% ;
- Shqyrtimi kushtetues i vendimeve të autoriteteve tjera publike, 8 raste ose 5, 3%;
- Shqyrtimi kushtetues i vendimeve të gjyqësorit,1 rast ose 0,7% dhe
- Shkelje të tjera, 5 raste ose 3,3 %.

SHKELJET E SUPOZUARA, SIPAS LLOJIT TË SHKELJEVE
(1.1.2016- 31.12.2016)



6. Shkeljet e pretenduara të të drejtave

- 130 kërkesa ose 86,1% kanë të bëjnë me shkelje që pretendohen të jenë kryer me anë të vendimeve të gjykatave;
- 17 kërkesa ose 11,3% kanë të bëjnë meshkelje që pretendohen të jenë kryer nga autoritetetë tjera publike; dhe
- 4 kërkesa, ose 2,6% kanë të bëjnë me interpretime (sqarime) kushtetuese.

SHKELËSIT E SUPOZUAR TË TË DREJTAVE
(1.1.2016- 31.12.2016)



7. Seancat dhe kolegjet shqyrtuese

Gjatë vitit 2016, Gjykata Kushtetuese ka mbajtur 32 seanca plenare, dhe 122 kolegje shqyrtuese në të cilat rastet e shqyrtuara u zgjidhën me aktgjykime, aktvendime, vendime për hedhje poshtë të kërkesës, vendime për refuzim të kërkesës dhe vendime për masë të përkohshme. Në këtë periudhë kemi një mendim mospajtues (në rastin e Aktgjykimit KI135/14). Struktur e 143 vendimeve të publikuara është si në vijim:

- 5 Aktgjykime,
- 131 Aktvendime,
- 4 Vendime për refuzim të kërkesës,
- 2 Vendime për hedhje poshtë të kërkesës dhe
- 1 Vendim për vazhdimin e masës së përkohshme.

STRUKTURA E VENDIMEVE NË NUMËR DHE PËRQINDJE (1.1.2016- 31.12.2016)



DEPARTAMENTI I BUXHETIT DHE FINANCAVE (DBF)

IV. DEPARTAMENTI I BUXHETIT DHE FINANCAVE (DBF)

Mjetet e ndara nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës për Gjykatën Kushtetuese për vitin 2016 janë **1,541,413.00€,** ndërsa me rishikim të buxhetit në vitin fiskal 2016 janë **1,501,013.00€**, ndryshimi i buxhetit me rishikim është **40,500.00€.**

Me vendimet e Qeverisë nr.07/112, i datës 18.10.2016 për kursime të mjeteve në kategorinë e pagave dhe mëditjeve në shumë prej 25,000.00€.
Me Vendimin e Qeverisë nr.11/120, i datës 14.12.2016 për kursime të mjeteve në kategorinë e Investime kapitale 14,500.00€.
Me vendimet e Qeverisë nr.01/123, i datës 28.12.2016 për kursime të mjeteve në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve në shumë prej 1,329.49€, ndryshim i buxhetit pas rishikimit është **40,829.49€.**
Buxheti final në SIMFK për vitin fiskal 2016 është **1,460,183.51€,** si dhe donacione të mbetura nga vitet e mëhershme në shumë prej 22,457.00€. dhe sipas strukturës përkatësisht kategorive ekonomike, pasqyrohen në paraqitjet tabelore.

Paga dhe mëditje	Mallra dhe shërbime	Shpenzime komunale	Investime Kapitale	Subvencione dhe transfere	Gjithsej
967,548.00€	487,102.51€	3,000.00€	2,533.00€	0.00€	1,460,183.51€

Paga dhe mëditje	Mallra dhe shërbime	Shpenzime komunale	Investime Kapitale	Subvencione dhe transfere	Donacione	Gjithsej
967,548.00€	487,102.51€	3,000.00€	2,533.00€	0.00€	22,457.00€	1,482,640.51€

Buxheti i aprovuar 2016, alokimi dhe realizimi për periudhën Janar – Dhjetor

	Buxheti i aprovuar 2016 (A) €	Alokimet janar- dhjetor (B) €	Realizimet janar-dhjetor (C) €	% (C/A) €	% (C/B) €
Paga dhe mëditje	967,548.00	955,388.54	955,388.54	98.74	100
Mallra dhe shërbime	487,102.51	487,102.51	487,102.51	100	100
Shpenzime komunale	3,000.00	3,000.00	2,497.88	83,26	83.26
Subvencione dhe transfere	0,00	0.00	0.00	0.00	0.00
Investime kapitale	2,533.00	2,533.00	2532.09	99.96	99.96
Gjithsej	1,460,183.51	1,448,024.05	1,447,521.02	99.13	99.96

Alokimet e mjeteve nga buxheti i Kosovës sipas rrjedhjes së parasë për periudhën Janar – Dhjetor

Në buxhetin e përgjithshëm pjesëmarrja e alokimit në vitin fiskal 2016 ka qenë 1,448,024.05€, e shprehur në përqindje 99.16%.

	Janar-Shtator €	Tetor €	Nëntor €	Dhjetor €	Gjithsej €	%
Paga dhe mëditje	713,235.23	78,377.83	81,016.82	82,758.66	955,388.54	98.78
Mallra dhe shërbime	419,968.00	38,467.00	20,000.00	8,670.51	487,012.51	100
Shpenzime komunale	3,000.0	0.00	0.00	0.00	3,000.00	100
Subvencione dhe transfere	0.00	0,00	0.00	0.00	0.00	0.00
Investime kapitale	2,533.00	0.00	0.00	0.00	2,533.00	0.00
Gjithsej	1,138,733.23	118,542.88	99,318.77	91,429.17	1,448,024.05	99.16

Realizimi i buxhetit për periudhën Janar – Dhjetor

Realizimi i buxhetit në bazë të alokimit në vitin fiskal 2016 ka qenë 1,447,521.02€ e shprehur në përqindje 99.96%.
Realizimi i buxhetit pasqyrohet si në vijim:

	Alokimet janar – dhjetor (A) €	Realizimi janar – dhjetor (B) €	Mbetja e mjeteve (C) €	% (B/A) €
Paga dhe mëditje	955,388.54	955,388.54	0.00	100
Mallra dhe shërbime	487,102.51	487,102.51	0.00	100
Shpenzime komunale	3,000.00	2,497.88	502.12	83.26
Subvencione dhe transfere	0.00	0.00	0.00	0.00
Investime kapitale	2,533.00	2,532.09	0.91	99.96
Gjithsej	1,448,024.05	1,447,521.02	503.03	99.96

Realizimi i buxhetit për paga dhe mëditje

Realizimi i pagave dhe mëditjeve sipas muajve:

Muaji	Numri i punëtorëve	Buxheti	Realizimi	Mbetja
Janar	65	80,403.47	80,403.47	0.00
Shkurt	65	82,281.46	82,281.46	0.00
Mars	65	80,513.57	80,513.57	0.00
Prill	64	78,867.51	78,867.51	0.00
Maj	64	79,488.79	79,488.79	0.00
Qershor	64	78,826.71	78,826.71	0.00
Korrik	63	76,898.50	76,898.50	0.00
Gusht	63	78,278.96	78,278.96	0.00
Shtator	63	77,676.26	77,676.26	0.00
Tetor	64	78,377.83	78,377.83	0.00

Nëntor	65	81,016.82	81,016.82	0.00
Dhjetor	65	82,758.66	82,758.66	0.00
Gjithsej		955,388.54	955,388.54	0.00

Realizimi i buxhetit për mallra dhe shërbime

Realizimi i buxhetit në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve për vitin 2016 të ndara sipas muajve:

Muaji	Buxheti	Alokimi	Realizimi	Mbetja
Janar	64,965.00	64,965.00	47,052.95	17,912.05
Shkurt	52,000.00	52,000.00	43,853.66	8,146.34
Mars	53,000.00	53,000.00	35,351.89	17,648.11
Prill	50,000.00	50,000.00	46,839.78	3,160.22
Maj	45,000.00	45,000.00	62,304.49	-17,304.49
Qershor	40,000.00	40,000.00	42,792.34	-2,792.34
Korrik	45,000.00	45,000.00	31,985.37	13,014.63
Gusht	20,000.00	20,000.00	30,317.66	-10,317.66
Shtator	50,000.00	50,000.00	43,835.42	6,164.58
Tetor	38,467.00	38,467.00	44,513.62	-,046.62
Nëntor	20,000.00	20,000.00	42,262.98	-22,262.98
Dhjetor	8,670.51	8,670.51	15,992.35	-7,321.84
Gjithsej	487,012.51	487,012.51	487,102.51	0.00

Buxhetit i ndarë për investime kapitale sipas kodeve të projekteve

Projektet	Kodet e projekteve	Buxheti i aprovuar €	Realizimi €	Mbetja €
Furnizim me UPS	15008	2,533.00	2,532.09	0.91
Gjithsej		2,533.00	2,532.09	0.91

Realizimi i buxhetit për shpenzime komunale

Realizimi i buxhetit në kategorinë të shpenzimeve komunale për vitin 2016 të ndara sipas muajve:[1]

Shpenzimet e komunaleve	Destinimi	Kodi ekonomik	Buxheti i aprovuar €	Alokimet janar – dhjetor	Realizimi €
	Shpenzimet e telefonisë fikse	13250	3,000.00	3,000.00	2,497.88

[1]Shpenzimet e komunalive nga Gjykata Kushtetuese e Kosovës janë bërë vetëm në kodin e telefonisë fikse, shpenzimet e rrymës, mbeturinave i mbulon Ministria e Administratës Publike.

NJËSIA E PROKURIMIT

(NJP)

V. NJËSIA E PROKURIMIT (NJP)

Më 12 janar 2016, Njësia e Prokurimit ka dorëzuar planin përfundimtar të prokurimit për vitin 2016 në Agjencinë Qendrore të Prokurimit Publik, në pajtim me nenin 8, pika 8.2 e Ligjit të Prokurimit Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-237, Ligjin nr. 05/L-068 dhe Ligjin nr. 05/L-092.

Njësia e Prokurimit ka iniciuar dhe zhvilluar gjithsej 32 aktivitete të prokurimit në mbështetje të Planit Përfundimtar të vitit 2016.

Aktivitetet e prokurimit janë klasifikuar sipas tipit, vlerës dhe procedurës në bazë të Ligjit e Prokurimit Publik. Ato janë detajuar siç vijon:

Procedurë e hapur (vlerë e mesme).

Gjatë vitit 2016 janë iniciuar dhe zhvilluar gjithsej 9 (nëntë) aktivitete dhe janë nënshkruar 12 (dymbëdhjetë) kontrata:

1. Shërbime me pije joalkoolike dhe pije të nxehta për nevoja të stafit të Gjykatës Kushtetuese;
2. Dy Lote për furnizim me pajisje të IT-së –;
   - Lot 1 Furnizim me PC Destop, Loptop dhe UPS;
   - Lot 2 Furnizime me pajisje përcjellëse të IT-së;

3. Tri Lote të Servisimit dhe mirëmbajtjes së automjeteve të GJKK-së -;
   - Lot 1 Servisimi dhe mirëmbajtja e automjeteve VW, Audi dhe Shkoda;
   - Lot 2 Servisimi dhe mirëmbajtja e automjetit Toyota RAV4; dhe
   - Lot 3 Servisimi dhe mirëmbajtja e automjetit MitsubishiLancer 1.5 benzinë;

4. Furnizim me material zyrtar;
5. Shërbime të ofrimit të frunizimeve punim dore nga argjendi;
6. Furnizim me bileta aeroplani;
7. Sigurimi i automjeteve zyrtare TPL, TPL Plus dhe Kasko e plotë EU;
8. Servisimi dhe mirëmbajtja e pajisjeve të IT-së (PC, Loptop, Printer, UPS, Scaner);
9. Dy Lote të Servisimit të pajisjeve të zërimit dhe pajisjeve të sigurisë;
   - Lot 1 Servisimin e sistemit të zërimit dhe përkthimit simultan; dhe
   - Lot 2 "Servisimin e pajisjeve të sigurisë";

a. Procedurë e negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë (vlerë e mesme)

Gjatë vitit 2016 është iniciuar dhe zhvilluar 1 (një) aktivitet dhe ka nënshkruar gjithsej 5 (pesë) kontrata:

b. Procedurë e kuotimit të çmimeve (vlerë e vogël)

Gjatë vitit 2016, NJP ka iniciuar dhe zhvilluar gjithsej 9 (nëntë) aktivitete dhe ka nënshkruar gjithsej 9 (nëntë) kontrata.

1. Furnizim me libra të ndryshëm për GJKK-në;
2. Furnizim me aparate telefoni (SmartPhone) për nevoja të gjyqtarëve të GJKK-së;
3. Furnizimi dhe montimi i sistemit për lexues të kartelave (akses kontroll);
4. Furnizim me material reprezentativ me logo të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës;
5. Shërbime të trajnimit për stafin e GJKK-së në sistemin ECDL;
6. Lyerja e brendshme me ngjyrë e objektit të GJKK-së;
7. Shërbime të dizajnimit dhe funksionalizimit të dy zyrave në objektin e GJKK-së;

8. Shërbime të botimit të materialeve për nevoja të GJKK-së;
9. Shërbime të mirëmbajtjes së softwerit (CDMS).

Procedurë me vlerë minimale

Gjatë vitit 2016 NJP ka iniciuar dhe zhvilluar gjithsej 13 (trembëdhjetë) aktivitete dhe ka nënshkruar 13 (trembëdhjetë) kontrata.

1. Veshja me pëlhurë e karrigeve zyrtare të GJKK-së;
2. Shërbime të furnizimit me artikuj reprezentativ;
3. Furnizim me pelerina për dy gjyqtaret e GJKK-së;
4. Shërbimet teknike të ngjyrosjes dhe politurë të automjetit – Passat 2.0 TDI HIGHLINE (4 MOTION), viti i prodhimit 2013;
5. Ndërrimi i centralit dhe servisimi detektorëve të tymit;
6. Servisimi dhe mbushja me gaz i klimës MIDEA (MGA-D65/SN2) si dhe mbushja me gaz e klimave ekzistuese sipas nevojave në objektin e Gjykatës Kushtetuese;
7. Furnizim me invertorë për dhomën e serverëve në GJKK;
8. Instalimi i tokëzimit dhe servisimi i gjeneratorit;
9. Furnizim me klima, montim dhe mbushja e klimave me freon si dhe demontimi i një klime dhe vendosja në zyrën tjetër;
10. Shërbime të mbikëqyrjes dhe konsulencës profesionale;
11. Riparimi dhe servisimi i ashensorit hidraulik;
12. Furnizim me gardërobë për vozitës të GJKK-së;
13. Rekuizita për delegacione me rastin e vitit Gjyqësor të GJKK-së.

Pasqyrimi në tabelë i të gjitha pagesave të realizuara gjatë vitit 2016 si dhe pagesat e kontratave afatgjata të nënshkruara nga NjP.

Pagesat e furnizimeve, shërbimeve dhe punëve për kontratat e nënshkruara nëpër vite.		Shuma e përgjithshme sipas viteve
i.	Pagesat e kontratave të nënshkruara në vitin 2012 & 2013	23,626.53 €
ii.	Pagesat e kontratave të nënshkruara në vitin 2014	148,657.42 €
iii.	Pagesat e kontratave të nënshkruara në vitin 2015	63,164.96 €
iv.	Pagesat e kontratave të nënshkruara në vitin 2016	92,183.56 €
Shuma e përgjithshme (i+ii+iii+iv)		**327,632.47 €**

NJËSIA E TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT DHE MULTIMEDIAVE (NJTIKM)

VI. NJËSIA E TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT, KOMUNIKIMIT DHE MULTIMEDIAVE (NJTIKM)

NJTIKM-ja është përgjegjëse për ofrimin e shërbimeve dhe përkujdesjen profesionale në infrastrukturën e përgjithshme të teknologjisë informative në Gjykatën Kushtetuese.

Gjatë viti 2016, NJTIKM-ja ka realizuar projekte dhe detyra sipas planit dhe përgjegjësive të saj, duke krijuar një sistem të qëndrueshëm dhe profesional me pajisje të avancuara teknologjike, në përputhje me planin strategjik të Gjykatës Kushtetuese.

Projektet e realizuara

- Implementimi i sistemit të Akses Kontrolleve për regjistrimin e hyrje-daljeve përmes IR-kartelave në objektin e Gjykatës;
- Implementimi i IPTV për gjyqtarët përmes platformës VOIP, të lidhura nga PTK;
- Krijimi i formularit për parashtrim të kërkesës formë elektronike në Gjykatën Kushtetuese dhe publikimi në Ueb Faqen zyrtare;
- Modifikimi i sistemit të kamerave të sigurisë dhe video-vëzhgimit, zëvendësimi dhe avancimi me kamera analoge në HD, për ngritjen e sigurisë së objektit;
- Përpilimi i projekt-propozimit për trajnimet e stafit në ECDL.

Aktivitetet e ndërmarra

- Menaxhimin dhe organizimin e detyrave teknike dhe operative brenda Njësisë;
- Kontrollimi dhe mirëmbajtja e sistemit të domenit të Gjykatës dhe krijimi i politikave të sigurisë në serverët e Gjykatës;
- Përfundimi i dizajnit të revistës "Buletini informativ" dhe dërgimi në Drejtorinë për informim;
- Inicimi dhe specifikimi i proceseve për blerjen e pajisjeve të IT-së sipas planit të paraparë;
- Avancim në ngritjen e sistemeve operative në Windows 10 dhe softuerët tjerë aplikativ;
- Krijimi i back-up dhe ruajtja e tyre në hapësirën e Data-Center të ASHI-së;
- Përditësimi i versioneve të reja për IP-tel, nxjerrja dhe analizimi i shpenzimeve nga sistemi i telefonisë VOIP;
- Pjesëmarrja në dy punëtori për Planin Strategjik të Gjykatës Kushtetuese;
- Pjesëmarrje në trajnimin "IT - Project Managment";
- Pjesëmarrja në trajnimin "Course 20410: Installing and Configuring Windows Server 2012";
- Përkujdesja dhe mbarëvajtja e sistemit të përkthimeve të seancave në gjykatore;
- Janë publikuar 142 vendime në Ueb Faqe në tri gjuhët zyrtare;
- Përkujdesje dhe ofrim të shërbimeve për mbarëvajtjen e sistemeve dhe pajisjeve të teknologjisë Informative dhe komunikimit;
- Përkujdesje në krijimin i kopjeve (back-up) të domenit të Gjykatës dhe sistemit të CDMS-it.

AUDITIMI

VII. NJËSIA E AUDITIMIT TË BRENDSHËM (NJAB)

1. Auditimi i brendshëm

Bazuar në planin vjetor për vitin 2016, NJAB ka përfunduar me kohë të gjitha auditimet e planifikuara, si:

- Menaxhimi i regjistrimit të lëndëve dhe arkivit;
- Menaxhimi i personelit;
- Menaxhimi i automjeteve;
- Menaxhimi i shpenzimeve;
- Menaxhimi i prokurimit.

NJAB ka hartuar dhe ka dorëzuar brenda afatit të caktuar:

- Planin strategjik të auditimit të brendshëm për periudhën 2017-2019;dhe
- Planin vjetor të auditimit të brendshëm për vitin 2017.

NJAB ka kryer të gjitha auditimet e brendshme në pajtim me legjislacionin në fuqi dhe me qëllim të realizimit të objektivave të institucionit dhe të NJAB që kanë të bëjnë me kontrollin e brendshëm dhe me përmirësimin e efikasitetit në punë, me shmangien e gabimeve të mundshme, me rritjen e vlerës dhe me raportimin e parregullsive dhe gabimeve me qëllim të shtimit të kontrollit që të ofrojë siguri tek menaxhmenti për funksionim efikas në departamentet përkatëse.

NJAB në vazhdimësi ka bërë vizita përcjellëse për efikasitetin e sistemeve të menaxhimit dhe të funksionimit të kontrollit të brendshëm, si dhe të zbatimit të rekomandimeve nga Auditori i Brendshëm dhe nga Auditori i Përgjithshëm.

Menaxhmenti ka vlerësuar punën e auditorëve dhe në këtë drejtim është kujdesur për implementimin e rekomandimeve të dhëna si nga auditori i brendshëm, edhe nga auditorët e përgjithshëm. Kjo ka ndikuar në ngritjen e cilësisë së aktiviteteve dhe performancës së institucionit.

NJAB ka realizuar planin për vitin 2016 dhe ka bërë përcjelljen për zbatimin e rekomandimeve.

2. Komiteti i Auditimit të Brendshëm

Komiteti i Auditimit të Brendshëm është organ i pavarur këshillëdhënës - në Gjykatën Kushtetuese. Ai Komitet funksionon bazuar në:

- Udhëzimin Administrativ nr. 11-2010 për Themelimin dhe Funksionimin e Komitetit të Auditimit në subjektet e Sektorit Publik;
- Statutin e Komitetit të Auditmit të Brendshëm (KAB);
- Praktikat e mira; dhe
- Standardet ndërkombëtare të auditimit.

Gjatë vitit 2016 Komiteti i Auditimit të Brendshëm ka mbajtur 4 takime dhe siguron mbikëqyrje të planeve, raporteve dhe implementimit të rekomandimeve të dhëna nga auditorët.

3. Auditimi i Jashtëm

Zyra Kombëtare e Auditimit, për pasqyrat financiare të vitit 2016 ka kryer auditimin e ndërmjetëm në muajin dhjetor 2016. Gjykata ka pranuar Memon e auditimit, ku konstatohet se "*Menaxhimi dhe realizimi i buxhetit ishin në nivel të mirë, 73% i realizimit të buxhetit për periudhën nëntëmujore janar-shtator 2016. Po ashtu edhe kontrollet në fushën e shpenzimeve, menaxhimit të personelit dhe pasurive janë funksionale dhe po zbatohen në mënyrë efikase. Gjithashtu, GJKK ka përgatitë planin vjetor të organizatës në përputhje me atë strategjik. Për më tutje, GJKK ka përgatitur edhe regjistrin e rreziqeve dhe menaxhimit të tyre.*"
Gjykata Kushtetuese për këtë fazë të auditimit ka pranuar vetëm një (1) këshillë për menaxhmentin.

Njësia Ligjore

(NJL)

VIII. NJËSIA LIGJORE (NJL)

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës punëson një numër të juristëve në nivele të ndryshme, të cilët përkrahin punën profesionale të gjyqtarëve dhe të administratës së Gjykatës. Asistenca për gjyqtarët ka të bëjë kryesisht me këshillime në çështjet e ngritura para Gjykatës, që kanë të bëjnë me raste të natyrave të ndryshme. Këshilltarët posaçërisht ndihmojnë në hartimin e korrespondencës, në përgatitjen e raporteve dhe të vendimeve për Gjykatë dhe kujdesen po ashtu për procedurat e tjera derisa vendimet e Gjykatës të marrin formën përfundimtare.

Megjithatë, Këshilltarët juridikë që punojnë në Gjykatë nuk janë shërbyes civilë; ata kanë statusin e të punësuarit profesionistë me kohë të pacaktuar, me kushte të punës specifike siç përcaktohet me Ligjin për Gjykatë, Rregullore të punës dhe Udhëzimin praktik për Njësinë Ligjore. Sa i përket këshillimeve që ofrojnë ata janë të pavarur.

Njësia Ligjore aktualisht përbëhet nga 11 (njëmbëdhjetë) këshilltarë juridikë (senior), 2 (dy) këshilltarë juridikë (junior) dhe 1 (një) sekretare juridike. Kompozicioni i tanishëm i Njësisë Ligjore në përbërjen e vet ka edhe një këshilltar juridik (senior) ndërkombëtar. Anëtarët vendorë të Njësisë përkasin etnive të ndryshme.

Njësia Ligjore menaxhohet nga këshilltari i Parë juridik dhe nga dy zëvendëskëshilltarë të Parë juridikë. Këshilltari i Parë juridik ndërlidhet me Kryetarin e Gjykatës dhe Sekretarin e Përgjithshëm.

Njësia Ligjore mban takime të rregullta një herë në javë për të diskutuar çështje të ndryshme kushtetuese, për të përcjellë gjendjen e rasteve, për të rishikuar mundësitë e akteve të brendshme të Gjykatës si dhe mban konsultime rreth praktikës gjyqësore.

Për më tepër, që nga themelimi i saj e deri më sot, Njësia Ligjore vazhdon të mbajë një bazë të dhënash, ku të gjitha rastet janë të rregulluara në bazë të llojit të vendimit, të natyrës së të kontesteve, të natyrës së shkeljeve të konstatuara etj. Kjo bazë e të dhënave menaxhohet nga një grup i këshilltarëve juridikë. Detyrë kryesore e këtij grupi është që të sigurojë raporte hulumtuese për të ndihmuar gjyqtarët dhe këshilltarët juridikë në punën e tyre në rastet e pazgjidhura.

Sa i përket përcjelljes së gjendjes së rasteve, Njësia Ligjore mban një raport të rasteve ku përshkruhet ecuria e rastit, nga momenti kur rasti i caktohet këshilltarit juridik e deri në publikimin e tij në ueb-faqen zyrtare të Gjykatës.

Faktor i rëndësishëm në sigurimin e vendimmarrjes efikase juridike dhe të ngritjes së hartimit të raporteve dhe të vendimeve, është trajnimi i profesionistëve të Gjykatës në fusha të ndryshme të punës. Në kuadër të aktiviteteve të Gjykatës, anëtarët e Njësisë Ligjore morën pjesë në punëtori profesionale gjatë tërë vitit. Lista e plotë e aktiviteteve të këshilltarëve juridikë mund të gjendet në Pjesën VII të këtij raporti (Aktivitetet e Gjykatës).

Gjykata, në bashkëpunim me Këshillin e Evropës dhe me Ambasadën e Zvicrës, ka përmbyllur me suksese projektin e vizitave studimore (2014-2016) për këshilltarët e saj juridikë, që ka konsistuar në dërgimin e dy këshilltarëve juridikë në çdo 5 (pesë) muaj në Sekretariatin e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në Strasburg. Qëllimi i këtij projekti ka qenë trajnimi i këshilltarëve juridikë nëpërmjet ngritjes së aftësive të hartimit të raporteve paraprake dhe të vendimeve.

Këshilltarët juridikë gjithashtu kanë ndjekur 10 (dhjetë) punëtori të tjera profesionale të organizuara nga Këshilli i Evropës, Zyra në Prishtinë, përkitazi me analizimin dhe me studimin e rasteve specifike për nenin 2, 3, 5, 6, 8, 10, 13 dhe 14 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Njësia Ligjore vazhdon të jetë e përkushtuar në ngritjen e profesionalizmit të saj, nëpërmjet realizimit të projekteve të ndryshme, që ofrohen dhe mundësohen nga donatorët dhe partnerët strategjikë të Gjykatës Kushtetueses.

ZYRA PËR KOMUNIKIM DHE INFORMIM

(ZKI)

IX. ZYRA PER KOMUNIKIM DHE INFORMIM (ZKI)

ZKI në fushën e përgjegjësive të saj përfshinë informimin dhe komunikimin me mediat/publikun, komunikimin me palët/qytetarët, protokollin, qasjen në dokumentet zyrtare të Gjykatës, si dhe bashkëpunimin me Komisionin e Venecias.

Gjatë vitit 2016, ZKI ka kryer aktivitetet si në vijim:

I. Komunikimi me mediat/publikun:

- Janë përpiluar 43 raporte javore të medieve;
- Janë botuar Raporti vjetor i medieve për vitin 2016, 27 njoftime për medie dhe 49 njoftime të brendshme përkitazi me punën dhe aktivitetet e Gjykatës;
- Është bërë arkivimi fizik dhe elektronik i raporteve të medieve (351 artikuj) dhe të medieve elektronike (626 artikuj) për punën e Gjykatës;
- Janë dërguar përgjigjet në 114 pyetje të parashtruara nga mediat e shkruara dhe ato elektronike, si dhe 19 pyetje/kërkesa nga qytetarët.

II. Aktivitetet protokollare:

- ZKI ka përfunduar të gjitha detyrat protokollare përkitazi me 13 vizita zyrtare në Gjykatë, 12 vizita zyrtare jashtë vendit, 8 punëtori/konferenca në Kosovë dhe 4 punëtori/konferenca jashtë vendit.

III. Kërkesat për qasje në dokumente zyrtare:

- ZKI ka dorëzuardd Raportin vjetor për kërkesat për qasje në dokumentet zyrtare të Gjykatës gjatë vitit 2016;
- ZKI ka pranuar gjithsej 8 kërkesa për qasje në dokumentet zyrtare të Gjykatës; 7 kërkesa janë miratuar plotësisht dhe vetëm 1 kërkesë është miratuar pjesërisht.

IV. Komunikimi me palët/qytetarët:

Gjatë vitit 2016, recepsioni i Gjykatës regjistroi:

- 770 qytetarë;
- 127 përfaqësues institucionesh; dhe
- 23 përfaqësues mediash.

V. Bashkëpunimi me Komisionin e Venecias:

- Gjykata u përgjigj në 74 pyetje të parashtruara nëpërmjet Forumit të Komisionit të Venecias nga 13 gjykata kushtetuese dhe gjykata supreme të shteteve anëtare;
- ZKI ka dorëzuar 3 raporte katër-mujore, së bashku me vendimet më të rëndësishme të Gjykatës për publikim në Buletinet e Komisionit të Venecias;
- Gjykata dorëzoi 5 pyetje nga në Forumin e gjykatave kushtetuese dhe supreme të shteteve anëtare të Komisionit të Venecias. ZKI pranoi përgjigje nga 11 gjykata kushtetuese dhe supreme të shteteve anëtare.

AKTIVITETET E GJYKATËS KUSHTETUESE

X. AKTIVITETET E GJYKATËS KUSHTETUESE

I. Udhëtimet zyrtare

24 - 26 shkurt 2016

Një delegacion i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, i prirë nga kryetarja e Gjykatës, Arta Rama-Hajrizi, realizuan një vizitë zyrtare dyditore në Tiranë, më 24 shkurt 2016.

Gjatë qëndrimit në kryeqytetin shqiptar, delegacioni i Gjykatës Kushtetuese zhvilloi takime me kryetarin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, z. Bashkim Dedja, me kryetarin e Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë, z. Xhezair Zaganjori, si dhe me Ministrin e Drejtësisë të Republikës së Shqipërisë, z. Ylli Manjani.

Delegacioni i Gjykatës Kushtetuese dhe Kryetarja Rama-Hajrizi u pritën në takim të veçantë edhe nga Presidenti i Republikës së Shqipërisë, z. Bujar Nishani, më 26 shkurt 2016.

18 - 19 mars 2016

Gjyqtari Altay Suroy mori pjesë në Forumin e tretë rajonal për sundim të ligjit për Evropën Juglindore, me ftesë të AlRECentre dhe Civil RightsDefenders të mbështetur nga zyra e jashtme e Mbretërisë së Bashkuar dhe Qeveria Suedeze, më 18 dhe 19 mars 2016, në Sarajevë, Bosnje dhe Hercegovinë.

Qëllimi i Forumit ishte të promovohet zbatimi i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në rajon, bashkëpunimi rajonal në zhvillimin e vazhdueshëm të sundimit të ligjit dhe të drejtat e njeriut dhe për ta mbështetur procesin e integrimit rajonal në BE.

13 - 18 mars 2016

Z. Veton Dula, Drejtor i Zyrës për Komunikim dhe Informim dhe znj. Arta Balaj, Shefe e Kabinetit të Kryetares, realizuan një vizitë studimore Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe institucioneve të Këshillit të Evropës dhe morën pjesë në një seminar përkitazi me "Standardet e GJEDNJ-së dhe KE-së për të Drejtën e Lirisë së Shprehjes", më 13 - 18 mars 2016, në Strasburg, Francë.

Vizita në Strasburg ishte mbështetur nga Thomson Foundation dhe u ka ofruar mundësinë zyrtarëve të Gjykatës sonë të zgjerojnë më tej marrëdhëniet profesionale dhe të njoftohen me profesionistë të shquar të Këshillit të Evropës dhe të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në fushën e të drejtës dhe medieve.

23 - 25 mars 2016

Një delegacion i Gjykatës Kushtetuese i përbërë nga këshilltarë juridikë dhe punonjës administrativë qëndruan për vizitë studimore në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, nga 23 deri më 25 mars 2016.

Gjatë vizitës, delegacioni i Gjykatës Kushtetuese u njoftua për së afërmi me organizimin dhe

me metodat e punës të Departamentit Ligjor dhe të Departamenteve të tjera që funksionojnë në kuadër të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë.

25 - 26 prill 2016

Me ftesë të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Turqisë, një delegacion i Gjykatës Kushtetuese, i prirë nga kryetarja, znj. Arta Rama-Hajrizi morën pjesë në simpoziumin ndërkombëtar për: "*Zbatimin eaktgjykimeve përkitazi me ankesat kushtetuese dhe efekti i tyre*", i cili u mbajt në kryeqytetin turk, më 25 dhe 26 prill 2016.

Simpoziumi u organizua me rastin e kremtimit të përvjetorit të 54-të, të themelimit të Gjykatës Kushtetuese të Turqisë.

Gjatë qëndrimit në Ankara, kryetarja Rama-Hajrizi u takua edhe me kryetarin e Gjykatës Kushtetuese të Turqisë, z. ZühtüArslan, bashkë me të cilin nënshkruan një memorandum bashkëpunimi në emër të dy gjykatave. Memorandumi i bashkëpunimit përfshin një sërë aktivitetesh të përbashkëta në lëmin e hulumtimeve ligjore, të trajnimeve profesionale dhe të shkëmbimit të ndërsjellë të përvojave ndërmjet dy gjykatave kushtetuese.

18 - 21 Maj 2016

Sekretari i Përgjithshëm i Gjykatës Kushtetuese, z. Milot Vokshi dhe z. Admir Vokshi Drejtori i Financave, morën pjesë në Konferencën Ndërkombëtare mbi "*Gjenerata e Re e Auditim-it të Brendshëm – Zgjidhje e Problemeve 2016"*, mbajtur më 19 - 20 maj 2016, në Budapest të Hungarisë.

23 - 31 maj 2016

Me ftesë nga Asociacioni Ndërkombëtar i gjyqtareve gra të SHBA-ve, Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese Arta Rama-Hajrizi dhe Shefja e Kabinetit Arta Balaj realizuan një vizitë zyrtare në SHBA dhe morën pjesë në Konferencën e 13-të bienale ndërkombëtare e ANGJG-së për: "*Gjyqtaret Gra dhe Sundimi i Ligjit: Vlerësimi i së Kaluarës, Parashikimi i së Ardhmes*", i cili u mbajt më 26/29 maj 2016, në Uashington, SHBA.

6 - 9 qershor 2016

Z. Veton Dula, Drejtor i Zyrës për Komunikim, zyrtari ndërlidhës në mes të Gjykatës Kushtetuese me Komisionin e Venecias, mori pjesë në takimin e 15-të të Këshillit të Përbashkët të Drejtësisë Kushtetuese të Komisionit të Venecias, më 6 - 9 qershor 2016, në Venecia të Italisë.

22 - 24 qershor 2016

Me ftesë të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Sllovenisë, një delegacion i Gjykatës Kushtetuese, i prirë nga kryetarja, znj. Arta Rama-Hajrizi morën pjesë në kremtimin e përvjetorit të 25-të të themelimit të Gjykatës Kushtetuese të Sllovenisë të përcjellë me një Konferencë, më 23 qershor 2016, në Bled të Sllovenisë.

Gjatë qëndrimit në Slloveni, kryetarja Rama-Hajrizi u takua me kryetarin e Gjykatës Kushtetuese të Sllovenisë, z. MiroslavMozetič.

1 shtator 2016

Me ftesë të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Turqisë, gjyqtari Altay Suroy mori pjesë në inaugurimin e Ceremonisë së Vitit Gjyqësor të Gjykatës Supreme të Republikës së Turqisë, më 1 shtator 2016, në Ankara.

21 - 22 shtator 2016

Me ftesë të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Bullgarisë, kryetarja e Gjykatës Kushtetuese, znj. Arta Rama-Hajrizi, dhe gjyqtarja Snezhana Botusharova morën pjesë në konferencën ndërkombëtare në temën "*Mbrojtja e të drejtave themelore të qytetarëve dhe siguria kombëtare në botën moderne: Roli i gjykatave kushtetuese*", e organizuar me rastin e kremtimit të 25-vjetorit të themelimit të Gjykatës Kushtetuese të Bullgarisë.

Gjatë qëndrimit në Sofje, kryetarja Rama-Hajrizi dhe gjyqtarja Snezhana Botusharova janë pritur në takim të veçantë nga kryetari i Gjykatës Kushtetuese të Bullgarisë, z. BorisVelchev, ndërkaq takime të ndara kanë zhvilluar edhe me homologë të tjerë nga gjykatat kushtetuese rajonale dhe evropiane, pjesëmarrës në këtë konferencë ndërkombëtare.

17 - 19 tetor 2016

Me ftesë të Ministrisë të Drejtësisë së Republikës të Turqisë, gjyqtari Altay Suroy mori pjesë në Kongresi i të Drejtës Ndërkombëtare, më 17 – 19 tetor 2016, në Stamboll të Turqisë.

19 - 21 dhjetor 2016

Me ftesë të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Malit të Zi, Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese, znj. Arta Rama-Hajrizi, dhe gjyqtarja Gresa Caka- Nimani morën pjesë në konferencën ndërkombëtare për "Rolin e Gjykatës Kushtetuese në ndërtimin e shtetit ligjor dhe në mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut", e organizuar me rastin e kremtimit të 10 vjetorit të themelimit të Gjykatës Kushtetuese të Malit të Zi.

Gjatë qëndrimit të tyre në Mal të Zi, kryetarja Rama-Hajrizi dhe gjyqtarja Caka-Nimani janë pritur në një takim të veçantë nga kryetarja e Gjykatës Kushtetuese të Malit të Zi, znj. Desanka Lopičić, ndërkaq takime të ndara kanë zhvilluar edhe me homologë të tjerë nga gjykatat kushtetuese rajonale dhe evropiane, pjesëmarrës në këtë konferencë ndërkombëtare.

II. Vizita zyrtare në Gjykatën Kushtetuese/Aktivitete të tjera

19 janar 2016

Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese të prirë nga kryetarja, Arta Rama-Hajrizi, morën pjesë në Konferencën ndërkombëtare të organizuar nga Zyra e Këshillit të Evropës në Kosovë, për "*Interpretimi dhe zbatimi i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut nga gjykatat kushtetuese të vendeve të Ballkanit perëndimor*", më 19 janar 2016, në Prishtinë.

Kryetarja, Arta Rama-Hajrizi mbajti fjalim për *"Sfidat dhe perspektivat e zbatimit të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ) nga Gjykata Kushtetuese e Kosovës"*.

1 - 4 shkurt 2016

Gjykata Kushtetuese mbajti punëtorinë e Planit të Veprimit të Planit Strategjik të Gjykatës Kushtetuese, më 1 – 4 shkurt 2016, në Durrës, Shqipëri.

8 prill 2016

Një delegacion i Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë, në krye me kryetarin z. XhezairZaganjori, realizuan një vizitë kortezie në Gjykatën Kushtetuese, ku u mirëpritën nga kryetarja znj. Arta Rama-Hajrizi dhe gjyqtarët e Gjykatës.

18 - 21 prill 2016

Gjykata Kushtetuese organizoi punëtori orientuese për gjyqtarët e rinj të Gjykatës Kushtetuese, në Budvë, Mali i Zi.

10 - 12 maj 2016

Gjykata Kushtetuese mirëpriti një delegacion nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë. Me këtë rast, Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese, znj. Arta Rama-Hajrizi, priti në takim kryetarin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, z. Bashkim Dedja, i shoqëruar nga gjyqtarët znj. Altina Xhoxhaj dhe z. Fatmir Hoxha, më 11 maj 2016, në Prishtinë.

Delegacioni i Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë qëndroi për vizitë zyrtare në Kosovë me ftesë të Gjykatës Kushtetuese, me ç'rast u takua edhe me udhëheqës të institucioneve të tjera shtetërore.

13 maj 2016

Gjykatën Kushtetuese e vizituan një grup studentësh nga Fakulteti Juridik "Haxhi Zeka" nga Peja. Ata u mirëpritën nga gjyqtari z. Bekim Sejdiu dhe Këshilltari i Parë Ligjor z. Sevdail Kastrati. Qëllimi i kësaj vizite ishte diskutimi rreth kompetencave dhe sfidave ekzistuese të Gjykatës Kushtetuese.

maj 2016

Me përkrahjen e Projektit të Këshillit të Evropës për mbështetje në Zbatimin e Standardeve Evropiane për të Drejtat e Njeriut, janë mbajtur seminaret për këshilltarët ligjor të Gjykatës Kushtetuese për:

1. "*E Drejta e Lirisë së Tubimit nga neni 11 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Instrumente tjera Ndërkombëtare: Vështrim, Parimet dhe Rastet Kryesore*"; seminari ishte moderuar nga prof. dr. Alexander Vashkevich, profesor i Universitetit Evropian të Shkencave Humane (Vilnius, Lituani) dhe ish-gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese të Bjellorusisë dhe është mbajtur më 13 maj 2016, në Prishtinë.

2. *"Praktika Gjyqësore e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut mbi Neni 9 i Konventës dhe Neni 9 Liria e Fesë"*, mbajtur më 13 maj 2016, në Prishtinë.

3. *"Standardet Evropiane të Mbrojtjes nga Diskriminimi (me fokus në orientimin seksual dhe identitetin gjinor)",* mbajtur më 21 qershor 2016, në Prishtinë.

1 - 4 qershor 2016

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë në bashkëpunim me Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës zhvilluan një tryezë të përbashkët për *"Risitë e projekt ligjit për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese"*, në kuadër të Reformës në Drejtësi, mbajtur më 1 - 4 qershor 2016, në Sarandë, Shqipëri.

Një delegacion i Gjykatës Kushtetuese, i përbërë nga këshilltarë juridikë dhe punonjës administrativë, përfaqësuan Gjykatën Kushtetuese në këtë tryezë të përbashkët.

6 - 9 qershor 2016

Gjykata Kushtetuese mbajti punëtorinë e Planit të Veprimit të Planit Strategjik të Gjykatës Kushtetuese, më 6 – 9 qershor 2016, në Durrës, Shqipëri.

14 qershor 2016

Këshilltarët juridikë të Gjykatës Kushtetuese dhe këshilltarët e Gjykatës Supreme morën pjesë në punëtorinë e përbashkët për: "*Marrëdhëniet e Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës Supreme me medie*", e cila u mbajt më 14 korrik 2016, në Prishtinë.

E organizuar me përkrahjen e Fondacionit gjerman për bashkëpunim ligjor ndërkombëtar (IRZ), punëtoria kishte për qëllim trajnimin e këshilltarëve të të dyja gjykatave përkitazi me marrëdhëniet aktive dhe profesionale me mediet, përfitimet dhe përparësitë e marrëdhënieve të mira me publikun, si dhe interpretimin e vendimeve të gjykatave në medie.

Moderator i punëtorisë ishte Prof. dr. Jan Bergmann gjyqtari kryesues në Gjykatën e Lartë Administrative të LanditBaden-Württemberg në Gjermani, i cili ndër të tjera diskutoi edhe mbi dallimin ndërmjet konfidencialitetit dhe transparencës në punën e gjykatave.

6 - 9 shtator 2016

Gjykata Kushtetuese, në bashkëpunim me Gjykatën Supreme dhe me përkrahjen e Fondacionit gjerman për bashkëpunim ligjor ndërkombëtar (IRZ), organizuan punëtorinë për: "Antikorrupsion" në Selanik, më 7 dhe 8 shtator 2016.

Në punëtori morën pjesë gjyqtarë dhe këshilltarë juridikë nga të dy gjykatat, të cilët ndërmjet tjerash diskutuan dhe shkëmbyen pikëpamjet e tyre përkitazi me mekanizmat dhe me rolin e gjyqësorit në luftimin e korrupsionit, si dhe për të drejtën për gjykim të drejtë dhe të paanshëm në rastet e korrupsionit, duke u bazuar në praktikën e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës.

Pjesëmarrësit në punëtori patën rastin të njihen më për së afërmi edhe me praktikat dhe me instrumentet ndërkombëtare për parandalimin dhe luftimin e korrupsionit, e në veçanti me kornizën ligjore dhe me mekanizmat gjyqësorë për luftimin e korrupsionit në Austri.

Në këtë temë, me prezantimet e tyre u paraqitën Prof. dr. MatthiasHartwig, ligjërues i të Drejtës Ndërkombëtare Publike dhe i të Drejtës Kushtetuese në Universitetin e Heidelbergut në Gjermani, si dhe Dr. JohannesWindisch, prokuror publik në Prokurorinë Publike të

Austrisë për luftimin e krimit ekonomik dhe të korrupsionit në Vjenë, të cilët njëherësh ishin edhe moderatorë të punëtorisë.

6 tetor - 9 tetor 2016

Gjykata Kushtetuese mbajti punëtorinë e Planit të Veprimit të Planit Strategjik të Gjykatës Kushtetuese, më 6 - 9 tetor 2016, në Tiranë, Shqipëri.

25 tetor - 26 tetor 2016

Gjykata Kushtetuese shënoi Vitin e Shtatë Gjyqësor me një ceremoni solemne, më 26 tetor 2016, në Prishtinë.

Në këtë solemnitet, morën pjesë udhëheqësit më të lartë shtetërorë, përfaqësues të akredituar të misioneve diplomatike dhe të organizatave ndërkombëtare në vend, si dhe delegacionet e nivelit më të lartë të Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë, të Maqedonisë, të Turqisë, të Kroacisë, të Portugalisë, të Bullgarisë, të Malit të Zi, si dhe të Gjykatës së Lartë të Shqipërisë.

Me fjalim rasti, pjesëmarrësve në këtë ceremoni ju drejtuan kryetarja e Gjykatës Kushtetuese, znj. Arta Rama-Hajrizi, presidenti i Republikës së Kosovës, z. Hashim Thaçi, kryeministri i Republikës së Kosovës, z. Isa Mustafa, kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, z. Kadri Veseli, si dhe ministrja e Drejtësisë, znj. Dhurata Hoxha.

Më 27 tetor 2016, është mbajtur Konferenca e parë Ndërkombëtare për: "*Kontrollin incidental si mekanizëm kushtetues në sigurimin e kushtetutshmërisë së ligjeve në vendet në tranzicion*".

31 tetor - 1 nëntor 2016

Gjykata Kushtetuese në bashkëpunim me Projektin për reformë ligjore të Agjencisë gjermane për bashkëpunim ndërkombëtar (GIZ), organizoi punëtorinë për: "*Mediet dhe institucionet: Transparenca kundrejt konfidencialitetit*", më 31 tetor dhe 1 nëntor 2016, në Prishtinë.

Qëllimi i punëtorisë ishte diskutimi i sfidave me të cilat Gjykata Kushtetuese dhe institucionet e tjera shtetërore në vend, përballen në punën e tyre të përditshme në raport me mediat. Ndër të tjera, në punëtori janë trajtuar edhe çështjet e formave më praktike të komunikimit me mediat, hartimi dhe zhvillimi i objektivave strategjik të komunikimit, përzgjedhja e metodave më efektive të komunikimit, përgatitja e njoftimeve për media, si dhe kufiri ndërmjet transparencës dhe konfidencialitetit të punës së institucioneve në raport me mediat.

Moderator i punëtorisë ishte dr. Bernd Odörfer, gjyqtar dhe zëdhënës i Gjykatës së Lartë Rajonale të Shtutgartit, i cili më herët ishte i angazhuar edhe në cilësinë e zëdhënësit të Gjykatës Kushtetuese Federale të Gjermanisë.

8 nëntor 2016

Në kuadër të projektit të Këshillit të Evropës "Përmirësimi i mbrojtjes së standardeve evropiane për të drejtat e njeriut nga Gjykata Kushtetuese", financuar nga Qeveria e Zvicrës, Gjykata Kushtetuese organizoi seminar informativ për anëtarësim dhe bashkëpunim me Komisionin Evropian për Demokraci nëpërmjet Ligjit ("Komisioni i Venecias"), më 8 nëntor 2016, në Prishtinë.

Seminari informativ kishte për qëllim, në mënyrë të veçantë, përmirësimin e qëndrueshëm të të kuptuarit dhe të mbrojtjes efektive të normave evropiane për drejtat e njeriut nga Gjykata Kushtetuese dhe institucionet e tjera publike vendore. Seminari informativ, gjithashtu kishte për qëllim që të informojë aktorët kryesorë vendorë të përfshirë në punën e Komisionit të Venecias në lidhje me mandatin dhe funksionimin e tij në tri fusha kryesore - institucionet demokratike dhe të drejtat themelore, drejtësinë kushtetuese dhe zgjedhjet - dhe të sigurojë bazë për të diskutuar çdo çështje dhe sfidë që mund të lindë në raport me Komisionin e Venecias.

5 - 6 dhjetor 2016

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë në bashkëpunim me Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës zhvilloi një tryezë të përbashkët për "Zhvillimet më të fundit në veprimtarinë e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës dhe Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë", më 5 - 6 dhjetor 2016, në Durrës, Shqipëri.

Një delegacion i Gjykatës së Kushtetuese, i përbërë nga këshilltarë juridikë, drejtor dhe punonjës administrativë, përfaqësuan Gjykatën Kushtetuese në këtë tryezë të përbashkët.

15 dhjetor 2016

Në kuadër të projektit të Këshillit të Evropës "Përmirësimi i mbrojtjes së standardeve evropiane për të drejtat e njeriut nga Gjykata Kushtetuese", financuar nga Qeveria e Zvicrës, Gjykata Kushtetuese organizoi Forum Gjyqësor mbi sigurimin e zbatimit uniform të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut nga gjykatat kushtetuese dhe gjyqësorit të zakonshëm, më 15 dhjetor 2016, në Prishtinë.

Forumi Gjyqësor kishte për qëllim, në mënyrë të veçantë, përmirësimin e qëndrueshëm të të kuptuarit dhe të mbrojtjes efektive të normave evropiane për drejtat e njeriut nga Gjykata Kushtetuese dhe institucionet e tjera publike vendore. Forumi gjithashtu kishte për qëllim krahasimin e qasjes së gjykatave kushtetuese dhe të zakonshme rreth zbatimit të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, si dhe të sigurojë një forum diskutimi rreth roleve të tyre përkatëse në forcimin e të drejtave të njeriut dhe harmonizimin e praktikës gjyqësore në përputhje me standardet e Këshillit të Evropës.

SHTOJCA I

SHTOJCA I

Përmbledhje e llogarive të Gjykatës Kushtetuese për vitin 2016
Pasqyra e pranimit dhe pagesave në para të gatshme

		2016			2015			2014		
		Llogaria e vetme e Thesarit			Llogaria e vetme e Thesarit			Llogaria e vetme e Thesarit		
		BKK	TH V	Pagesat nga palët e treta të jashtme	BKK	TH V	Pagesat nga palët e treta të jashtme	BKK	TH V	Pagesat nga palët e treta të jashtme
	Shën.	€	€	€	€	€	€	€	€	€
Pranimet										
Ndarjet nga Fondi i përgjithshëm		1,445,955.62			1,406,124.00			1,384,900.00		
Grantet e përcaktuara të donatorëve								84,600.00		
Pranimet e tjera										
Totali i pranimeve		1,445,955.62	-		1,406,124.00	-	-	1,469,500.00	-	-
Pagesat										
Pagat dhe mëditjet	2	955,388.54			917,678.00			837,307.00		
Mallrat dhe shërbimet	3	485,537.11			485,328.00			595,351.00		
Shërbimet komunale	4	2,497.88			3,118.00			7,074.00		
		1,443,423.53			1,406,124.00			1,439,732.00		
Transferet dhe subvencionet	5									
Prona, ndërtesa dhe pajisjet	6	2,532.09						29,767.00		
Kthimi Huamarrjes	7									
Pagesat e tjera	8									
Pagesat gjithsej		2,532.09	-		-		-	29,767.00		-

Raporti mbi ekzekutimin e buxhetit

		2016				2015	2014
		Buxheti fillestar (Ndarja)	Buxheti final (Ndarja)	Realizimi	Dallimi	Realizimi	Realizimi
		A	B	C	D=C-B	E	F
	Shënime	€	€	€	€	€	€
Hyrja e parasë së gatshme në llogari të Thesarit							
Të hyrat atimore	9						
Të hyrat jo tatimore	10						
Të hyrat dedikuara	11						
Grantet dhe ndihma	12		22,457.00				84,600.00
Huamarrje	13						
Tjera	14						
Pranimet totale të mbledhura për BKK		-	22,457.00	-	-	-	84,600.00
Dalja e parasë së gatshme nga llogaria e Thesarit							
Pagat dhe mëditjet	2	1,022,548.00	967,548.00	955,389.00	(12,159.00)	917,678.00	837,307.00
Mallrat dhe shërbimet	3	489,965.00	487,103.00	485,537.00	(1,566.00)	485,328.00	595,351.00
Shërbimet komunale	4	4,000.00	3,000.00	2,498.00	(502.00	3,118.00	7,074.00
Transferet dhe subvencionet	5						
Shpenzimet kapitale	6	25,000.00	2,533.00	2,532.00	(1.00)	29,767	29,767.00
Fondi i privatizimit	7						
Të tjera	8						
Totali i pagesave i bërë nga BKK		1,541,513.00	1,460,184.00	1,445,956.00	(30,677)	1,406,124.00	1,469,499.00

Ndarjet e fondit të përgjithshëm për vitin 2016

	2016			2015	2014
	BKK	THV	Totali		
Klasifikimi ekonomik	€	€	€	€	€
Pagat dhe mëditjet	955,389.00		955,389.00	917,678.00	837,307.00
Mallrat dhe shërbimet	485,537.00		485,537.00	485,328.00	595,351.00
Shërbimet komunale	2,498.00		2,498.00	3,118.00	7,074.00
Shpenzimet kapitale	2,532.00				29,767.00
	1,445,956.00	-	1,445,956.00	1,406,124.00	1,469,499.00

ORGANOGRAMI

REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT



Perandori Justinian 44, 10000 Prishtinë/a, Kosovë/o
Tel: +381 (0)38 606 162; Fax: +381 (0)38 606 170; www.gjk-ks.org